



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA IV

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 84.

Prishtinë, më 13.12.2013 në ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Jasmina Živković, Elmi Reçica, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Lirije Kajtazi, Glauk Konjufca, Vesna Mikić Jelena Bontic, Mufera Sinik, Rasim Demiri dhe Mursel Halili.

Mungon: Petar Miletić.

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësues të OSBE-së, Lejla Selimi, përfaqësuese e Ambasadës Zvicerane Sakibe Jashari, përfaqësuese nga ECMI- Lura Pollozhani, përfaqësues i Sekretariatit të KKK - Zijush Ahmeti, përfaqësues nga RTK 2 Sonja Risic, përfaqësues UNOHCHR - Teodora Krumova, përfaqësues i CRDP Shkumbim Asllani, përfaqësuese e zyrës së EU (Unioni Evropian) – Blerta Bejtullahu, përfaqësues i zyrës së Presidencës (ZPRK) -Ukë Gashi dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit të Republikës së Kosovës- Celal Ilaz.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit, Koordinatorë - Natasa Prica-Tishma, zyrtarë e lartë ligjore- Drita Çarkaxhiu dhe praktikantë e UNP- Fjolla Gashi.

Mbledhjen e kryesoi: **Jasmina Živković**, kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1.Miratimi i rendit të ditës.

2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-172 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmoreve, invalidëve, veteranëve, pjesëtareve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre, me raport amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Të ftuar:

Kryetari i Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale. Z. Fitim Damka

Kryesuesja - konstatoi se janë krijuar kushtet për fillimin e mbledhjes, dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi – konstatoi se rendi i ditës u miratua, pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-172 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmoreve, invalidëve, veteranëve, pjesëtareve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre, me raport amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Kryesuesja – i njoftoi të pranishmit se për këtë takim është ftuar kryetari i Komisionit për Shëndetësi z. Fitim Damku. Për arsye të angazhimeve të kryetarit, prezent janë anëtarët e grupit Punues të komisionit për Shëndetësi, Liburn Aliu dhe Flora Brovina.

Komisioni ka thirr këtë takim, që të dy palët të arrijnë një marrëveshje të mirëfilltë për rishqyrtimin e Projektligjit nr. 04/L-172 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmoreve, invalidëve, veteranëve, pjesëtareve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,

Kryesuesja – në fjalën e saj tha se gjatë shqyrtimit të projektligjeve, Komisioni për Komunitete dhe Kthim është më tepër se sa konstruktiv.

Në kuadër të shqyrtimit të këtij projektligji, komuniteti jonë ka pasur vërejtje në Nenin 3, gjegjësisht formulimin e **amendamentit 1**, ku bëhet fjalë për ‘udhëheqjen e UÇK-së me qëllim të çlirimit të Kosovës dhe pavarësisë për popullin e Kosovës, e drejtuar kundër forcave ushtarake, okupuese serbe në Kosovë ‘.Dha sqarim se në ligje nuk është e nevojshme të mbetet formulimi ‘okupuese serbe në Kosovë’, sepse këto shprehje e gjeneralizojnë situatën dhe nuk është mirë një popull të kualifikohet në mënyrë etnike.

Bazuar në projektligj, ngriti edhe çështjen e periudhës kohore, duke shprehur qëndrimin e saj se nuk pajtohet që lufta në Kosovë ka përfunduar në vitin 1999 por 2000, nga se deri në këtë periudhë ka pësuar viktima tjera. Ajo kërkoi të përjashtohet kualifikimi etnik dhe të merren parasysh të gjitha viktimat e asaj periudhe.

Vesna Mikic – sa i përket këtij ligji ajo shprehu qëndrimin e saj se në luftë të armatosur nuk kanë marr pjesë vetëm populli shqiptar por edhe përfaqësues të nacionaliteteve tjera të cilët kanë humbur jetën e tyre dhe kërkohet të zbardhet fati i tyre.

Në përpilimin e amendamentit 1, të nenit 3, ku shkruan se në luftën e armatosur të udhëhequr nga UÇK, me qëllim të çlirimit të Kosovës e drejtuar kundër forcave ushtarake, policore dhe administrative okupuese serbe në Kosovë, veçoi se për atë periudhë nuk mundet të akuzohen vetëm qytetarët serbë. Kërkesa e saj ishte të mos përdoren këto shprehje të cilat dy palët i kthejnë në të kaluarën.

Diskutimi i saj ishte se Neni 1,6, përshkruan çështjen e pjesëtarëve të UÇK-së të cilët kanë rënë dëshmorë të Kombit për liri të vendit, ndërsa shprehet se për liri kanë ra edhe pjesëtarë të komunitetit serb dhe të komuniteteve tjera të cilët duhet të mbrohen me Ligj.

Vërejtje parashtrroi edhe për të internuarit e UÇK-së .

Në diskutimin e saj tha se në periudhën e vitit 1999, në Komunën e Gjilanit janë zhdukur 4 femra dhe ende nuk dihet për fatin e tyre. Propozimi i saj ishte që të mbetet si rregull që femrat e dhunuara të trajtohen dhe të kenë beneficinet e përcaktuara me Ligj,

Elmi Reçica –Ai theksoi se si komision i përhershëm, shqyrton të gjitha projektligjet që vijnë në Kuvend. Jemi në dijeni se projektligji është miratuar në Kuvend dhe nga komisioni funksional është shqyrtuar në formën më profesionale dhe raporti final është proceduar për shqyrtim në

komisionin ton. Komisioni, gjatë shqyrtimit të raporti me amandamente të Projektligjit, ka pasur vërejtje në amendamentin 1. nga pjesëtarët e komunitetit jo shumicë
Konsideron se amendamenti 1, përshkruan vetëm çështjen historike të asaj periudhe dhe se nuk preken interesat e komuniteteve pakicë që jetojnë në Kosovë

Duhet pranuar faktin se ka ndodh një luftë kundër okupatorit e udhëhequr nga UÇK-ja, e cila ka datën e themelimit dhe të përfundimit. Përgjegjësia jonë është që të jemi sa më konstruktiv kur bëhet fjalë për ligjet me interes të të gjithë qytetarëve që jetojnë në Kosovë.

Mursel Halili- pajtohet me parafolësin që të jemi konstruktiv të një kontestit se definimet e tilla po aludojnë në kaheje të kundërt. Kërkoj të gjendet mundësia për zgjidhjen e çështjes dhe të jenë të kënaqur të gjitha palët që përfshihen me ligj.

Glauk Konjufca – ai konsideron se amendamentit 1, i nenit 3. është formulim i saktë.

Sa i përket formimit të UÇK-së, ka qen gjithëpërfshirës, i organizuar në baza vullnetare, nën kontrollin civil të udhëheqjes politike me mision për mbrojtjen e popullit të Kosovës nga regjimi pushtues, dëbimin e forcave serbe nga Kosova dhe çlirimin e vendit.

Pra me këtë projektligj, përcaktohen dëshmorët e luftës që kanë ra në luftë për lirin e vendit.

Me zhvillimin e kësaj lufte shqiptarët kanë ngritur luftën për çlirim nga okupatori Slobodan Milosheviq dhe sot e gëzojnë lirin përveç komunitetit turk, romë edhe komuniteti serb.

Kundër kualifikimit etnik të okupatorit S. Milosevicit ishin **Jasmina Zivkovic dhe Vesna Mikic**, se me njeri si ai nuk mund të përshihet një komunitet i tërë. Shprehën qëndrimin e tyre që me këtë projektligj të përfshihen të gjitha viktimat e luftës së armatosur.

Liburn Aliu –si kryetar i grupit punues, paraqiti opinionin e tija lidhur me raport amandamentimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmoreve, invalidëve, veteranëve, pjesëtareve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre. Në diskutimin e tij, veçoi se si Komision funksional është përfunduar e gjithë procedurat e shqyrtimit të projektligjit dhe ka dalë me raport final i cili iu është adresuar për shqyrtim edhe Komisionit për Komunitete dhe Kthim. Komisioni jonë ishte në pritje që në afat prej dy javësh të ofrohen propozime apo amandamente nga Komisioni juaj ndërsa deri sot nuk është marrë asnjë përgjigje.

Sa i përket datave, pajtohet me datën që është dhënë në ligj. ekziston një datë e demartilizimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e cila ka vepruar në datë të caktuar dhe i tërë trajtimi është për atë periudhë kohore.

Flora Brovina – pas luftës duhet të kemi forcë që të falim ndërsa kjo falje asnjëherë nuk është kërkuar. Ky frustrim na pengon që të ecim përpara dhe për këtë çështje kam folur shumë herë të mos hakmerremi dhe mos t’ju ngajmë atyre që kanë shkaktuar shume të këqija Kosovës.

Ky Projektligj është hartuar me qëllimin më të mirë që të mos ofendohet asnjëra palë, t’ju pranohet viktimizimi sepse ju takon edhe me të drejtën ndërkombëtare. Këtu u fol për forcat ushtarake, policore okupuese serbe në Kosovë, ju lutem të keni parasysh se policia serbe ishte instrument i një shteti okupues i cili hoqi të drejtat e popullatës shqiptare, ndërsa ata që kanë vërejtje drejtat e tyre munden ti kërkojnë nga institucionet që i organizuan.

Sa i përket grave të dhunuara, kjo është një nder ngjarjet më të rënda të periudhës së luftës, gjë që e dëshmon numri i madh të tyre e më së shumti të përkatësisë shqiptare. Dhuna ndaj grave ishte instrument shtetërorë i policisë dhe ushtrisë serbe, nuk po flasë për individë por për instrumentet shtetërore serbe. Pajtohet se ka pasur dhunime edhe të nacionaliteteve tjera, janë dhunuar gratë e nacionalitetit ashkali sepse kanë folur në gjuhën shqip por ky instrument duhet të dënohet me ligj dhe viktimave t’ju pranohet viktimizimi.

Theksoi se ka pasur dhunime masovike, e përmendi shkollën e Qerezit ku me qindra gra janë dhunuar dhe masakruar, të cilat edhe në ditën e sotme jetojnë të traumatizua. Do të kalojë një periudhë e gjatë që të viktimizuarat të dëshmojnë pasi kjo ndikon në familjet e tyre dhe në shoqëri. Nëse thuhet se ka ndodhur dhunime të grave serbe, pas situatave të pasluftës, mendoj që kanë ndodhur individualisht dhe të tille raste mund të hetohen, nëse ka fakte.

Ajo shtoi se Ligji është në fuqi dhe sa i përket dhunimeve ato e kanë një adresë ku mund të drejtohen, tek institucionet e Kosovës që mbrojnë të drejta e njeriut, në polici të Kosovës, gjyqësia etj. .

Kryesuesja- nuk dëshiron të përmend shembullin e saj për periudhën e luftës por kërkon të vazhdohet me realitetin. Propozimi i saj ishte që të mbetet teksti i amendamentit 1, Lufta Çlirimtare të Kosovës, „ushtria çlirimtare e Kosovës të jete formulimi i armatosur për mbrojtjen e popullit të Kosovës, me karakter mbrojtës dhe çlirimtar, ndërsa pjesa tjetër të fshihet.

Vesna Mikic- theksoi se në çdo luftë nuk ka fitimtar por edhe humbës. Nuk pajtohet me formulimin e amendamentit 1, ku ekskluzivisht bëhet fjalë për forcat e administratës okupuese serbe në Kosovë. Propozimi i saj ishte që teksti i amendament të ndryshohet, në të kundërtën nuk do ta votojë projektligjin.

Liburn Aliu – Disi, Ju po përpiqeni, në njërën anë të barazoni popullatën e cila është mbrojtur në forma të ndryshme ndërsa në anën tjetër të jetë i favorizuar shteti i cili është drejtuar me administratë, ushtri, polici. Ai konsideron se politika dhe përgjegjësia e tillë bie ekskluzivisht mbi ta dhe individët e caktuar. Shteti i Serbisë ka qenë administratë okupuese pasi dihet se Kosovën e ka mbajtur nën dhunë. Nuk mendon se kjo bie në kundërshtim me atë që tha, nga shprehjet serbe nuk ka të bëjë me etnitet por me shtetësi.

Lumnije Morina – në ditën kur Komisioni për të Drejta, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar projektligjin, prej kryetares së komisionit ka qenë e vetmja vërejtje kontestuese lidhur me amendamentin 1, me arsyen se është përdorur shumë retorikë. Ajo mendon se nuk është përdorur retorikë aq sa thuhet. Mirëpo tani po bisedohet konkretisht se ajo është Ushtria, Policia dhe Administrata Okupuese Serbe, dhe pajtohet me Liburnin që nuk e din si është e shkruar në gjuhën serbe por në gjuhën shqipe kjo nënkupton vetëm Shtetin e Kosovës. Mendon se ne mund të dalim me një propozim konkret dhe i njëjti të dërgohet për ri-shqyrtim në komisionin funksional.

Elmi Recica - foli me bindje të plotë se ligji është i një rëndësie të veçantë andaj duhet të dalim me një qëndrim konkret pa lënduar atë që është qenësore. Në realitet, gjatë zhvillimit të periudhës së luftës ka pasur viktima të cilët kanë ra për lirin e Kosovës dhe të drejtat e tyre do të rregullohen me ligj. Mbetet të gjejmë mundësinë për ndryshimin e shprehjes ‘administratë e forcave policore, ushtarake serbe..

Për çështjet e ngritura, ai kërkoi që kryetari i Grupit punues z, Liburn Aliu, të ofroj opinionet e veta në përafrimin e mendimeve.

Liburn Aliu- në fjalën e tij tha se komisioni juaj nuk ka respektuar afatin kohor, edhe pse në mënyrë arbitrare kemi mundur projektligjin ta procedojmë në Seancë mirëpo qëndrimi ynë ishte që të mos anashkalojmë mendimet dhe sugjerimet e këtij komisioni.

Ai konsideron se koha për amendamente të reja ka kaluar, vërejtjet e juaja mund ti dërgoni me shkrim dhe do të shqyrtohen në komision ku më pas do të dalim me qëndrime konkrete.

Glauk Konjufca – nëse e kishim marrë këtë ligj pa e ditur si ka qenë versioni aktual dhe të lexojmë nenin 3, i cili thotë: e drejtuar kundër forcave ushtarake policore dhe administratës okupuese në Kosovë, është mirëpo por do të kishte pasur dilema po të kishte qenë i shkruar neni 3, ‘ e drejtuar kundër forcave ushtarake policore dhe administratës okupuese Shtetërore të shtetit të Serbisë. Pra versioni i amendamentit 3, eliminon çdo keqkuptim etnik .

Ai konsideron se lufta çlirimtare e Kosovës është luftë e armatosur me karakter çlirimtar.

Elmi Recica – Me këtë ligj , nuk mund të ndahen viktimat civile në baza nacionale, të gjitha viktimat duhet ti gëzojë të drejtat e barabarta.

Ai propozoi që në mbledhjen e radhës, anëtarët e komisionit të paraqesin propozim-amandament në nenin 3, të dilet me propozime konkrete ku i njëjti do ti dërgohet komisionit funksional për shqyrtim dhe vlerësim .

Jasmina Zivkovic – i përmbahet qëndrimit të saj se nuk ndryshon thelbi i projektligji nëse fshihet teksti i amendamentit 1. ‘ drejtuar ekskluzivisht kundër forcave ushtarake, policore dhe administratës okupuese serbe në Kosovë’ ndërsa të mbetet teksti i sipërsënuar.

Njëherit akordohet, që shqyrtimi i këtij amendamenti të shtyhet për mbledhjen e radhës ku do të dalim me propozim final.

Në kuadër të diskutimeve të anëtarëve, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim pajtohet se në njërin nga mbledhjet e radhës, anëtarët e komisionit të paraqesin propozimet e tyre të amendamentit 1, në Projektligjin nr. 04/L-172 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmoreve, invalidëve, veteranëve, pjesëtareve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ku propozimet me shkrim do ti dërgohet për shqyrtim komisionit funksional.

Glauk Konjufca – paraqiti vërejtjen e tij, mbledhjet e komisionit të mos caktohen ditën e hënë në ora 11:00, pasi në të njëjtën kohë mbahet mbledhja e Kryesisë së Kuvendit.

Jasmina Zivkovic – kërkoi ndjesë për mos respektimin e afatit dhe në të ardhmen këtë kërkesë do ta ketë në konsideratë.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetare e Komisionit

Jasmina Živković